



**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVA**

**KUVENDI / SKUPŠTINA /ASSEMBLY**

**Legjislatura-III**

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Social

Mbledhja nr. 2

Prishtinë, më 26 shkurt 2008, ora 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

**PROCESVERBAL**

nga mbledhja e Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Social

Në mbledhje morën pjesë: Sadik Idriz, Rita Hajzeraj , Teutë Hadri , Flora Brovina , Nurishahe Hulaj, Gjylnaze Syla, Qamile Morina dhe Mimoza Ahmetaj , ndërsa munguan Armend Zemaj, Bujar Bukoshi dhe Slllobodan Petroviq.

Nga zyra e komisioneve të Kuvendit: Shpresa Haxhijaj dhe Fatime Qorri

Mbledhjen e kryesoi z. **Sadik Idriz**, kryetar i Komisionit.

**RENDI I DITËS**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 3. Shqyrtimi i planit të punës së Komisionit për vitin 2008;**
- 4. Të ndryshme .**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**

Rendi i ditës u miratua pa plotësime .

## **2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**

**Mimoza Ahmetaj** bëri vërejtje lidhur me gabimet drejtshkrimore në procesverbal dhe kërkoj që këto gabime të përmirësohen .

**Gjynaze Syla** propozoj që në fjalimin e saj kur është fjala për mbajtjen e mbledhjeve në orar të njëjtë të jetë të maten në orën 11.

**Mimoza Ahmetaj** propozoj që përveç orarit të rregullt të mbledhjeve një herë në javë, Komisioni të mbaj edhe mbledhje jo të rregullta dhe të shqyrtoj ligjet para leximit të parë në Parlament, dhe të dal me qëndrime të caktuara lidhur me Projektligjet.

**Kryetari** tha se ne do të mbajmë mbledhje sipas nevojës dhe do ti shqyrtojmë ligjet me kohë , nëse kemi diçka parimore ne do ti shqyrtojmë edhe para leximit të parë.

## **3. Shqyrtimi i planit të punës së Komisionit për vitin 2008;**

**Kryetari** tha se kemi marrë një propozim të planit dhe mendojë se sot do ta diskutojmë ndërsa propozimet konkrete me shkrim do ta miratojmë në mbledhjen e radhës.

Plani i punës mund të rishqyrtohet edhe më vonë dhe shumë procese varen edhe nga ministrit përkatëse se çfarë propozimesh do të bëjnë. Hapi diskutimin për propozim planin e punës së Komisionit për vitin 2008.

**Gjynaze Syla** propozon që në parim të miratohet plani i punës këtë mbledhje e pastaj të plotësohet qoftë nga aspekti kohor ose edhe në vet çështjet .

**Mimoza Ahmetaj** tha se sipas muajve në planin e punës është parapa që P/Ligji për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit për Inspektoratin e Punës të shqyrtohet në mars ndërsa ai sot po lexohet në Parlament. Gjithashtu në muajin qershor parashihen tri pika por pasi në qershor bëhet rishikimi i buxhetit nga Qeveria edhe ne si Komision ta analizojmë buxhetin për shëndetësi se çka ka mundësi të ndryshohet të shtohet etj. Pra propozoj si pik e katër në muajin qershor të shtohet rishikimi i buxhetit për shëndetësi.

**Kryetari** tha se rishikimi i buxhetit bëhet pas përfundimit të gjashtëmujorit të par të punës , pastaj një muaj bëhen analizimet në Qeveri , pastaj janë pushimet kështu që në Kuvend do të vije në muajin shtator.

**Teuta Hadri** propozon që vizitat e parapara në institucione shëndetësore për muajin prill të barten në muajin mars pas gjendja në shëndetësi është mjaft e vështir.

**Flora Brovina** tha se Qeveris sonë i mungon një ligj shumë i rëndësishëm , Ligji i Punën me të cilin lidhen edhe shumë ligje tjera .Duhet që për këtë vit të parashihet miratimi i Ligjit për Sindikatat , Ligjin për Grevat dhe të zhvillohen edhe disa debate për këto ligje.

**Kryetari** tha se duke u bazuar në strategjinë legjislativë të Qeverisë, kemi parapa edhe planin e punës për vitin 2008 shqyrtimin e ligjeve.

Lidhur me Ligjin për Sigurime Shëndetësore ne kemi një shkresë nga PSSP-ja ku ceket se përse nuk është nënshkruar ky ligj dhe ku rekomandohet rishikimi i këtij ligji i cili nuk ka mundësi të nënshkruhet sepse nuk ka mjete buxhetore për implementim.

**Rita Hajzeraj** pyeti se a ka Komisioni buxhet të veçantë për sponsorizimin e ligjeve nga vet Komisioni.

**Qamile Morina** tha se në bazë të strategjisë legjislativë që na ka ardhur, Qeveria edhe një herë na tregon se nuk është fare e interesuar për shëndetësinë. Krejt ligjet e strategjisë janë nga lëmi i punës dhe mirëqenies sociale ndërsa nga shëndetësia nuk ka asnjë ligj. Mendoj se ne në çdo muaj duhet të shqyrtojmë diçka nga shëndetësia. Propozoj të punojmë në fuqizimin e ligjit për sigurimin shëndetësor sepse është e vetmja mënyrë për zgjedhjen e çështjes së shëndetësisë. Në sigurime sociale shëndetësore duhet të jetë mënyra e participimit nga të punësuarit.

Kisha edhe një pyetje se a ka Komisioni buxhet për vizita në vendet në rajon që janë në tranzicion për të fituar përvoja në hartimin sa më të mirë të ligjeve.

**Kryetari** tha se në mandatin e kaluar ka pas shumë ligje të miratuara nga shëndetësia ku disa janë nënshkruar e disa jo, por ne do të kemi mjaft punë nga lëmi i shëndetësisë e sidomos në monitorimin e institucioneve shëndetësore dhe institucioneve sociale dhe do të kemi edhe vizita në teren. Sa i përket Ligjit për Sigurime Shëndetësore, gjatë amendamentimit në Kuvend ka hyr edhe pushimi i lehonisë ku është rritur kostoja e ligjit në 154 milion dhe është i pa përballueshëm nga buxheti i Kosovës, gjithashtu për këtë vit buxheti për shëndetësinë nuk ka rritje.

Rekomandimet e Fondit Monetar kanë qenë se ky ligj është i pa përballueshëm për buxhetin e Kosovës. Ne prapë tani pas zgjedhjes së statusit do ta iniciojmë këtë çështje dhe ndoshta do të gjendet zgjidhje sepse unë disa herë kam than se nuk ka shëndetësi pa zbatimin e këtij ligji.

**Qamile Morina** tha se të gjitha shtetet që synojnë të hynë në Evropë ose që janë në Evropë deri në vitin 2012 duhet patjetër ta unifikojnë sigurimin shëndetësor social në bazë të solidaritetit.

**Flora Brovina** tha se disa punë janë bërë nga Komisioni në mandatin e kaluar dhe shumë është debati për Ligjin për Sigurime Shëndetësore por ka qenë rekomandimi i Fondit Monetar se nuk ka buxhet për implementim të këtij ligji. Ne tani do të insistojmë prapë dhe mendoj që edhe Qeveria do të interesohet që gjithsesi të gjej mundësin për të futë në praktik këtë ligj.

**Gjylnaze Sylja** propozon që në mbledhjen e ardhshme të sillen të gjitha propozimet me shkrim për plotësimin e planit të punës dhe që plani të miratohet.

**Kryetari** tha se sa i përket ligjeve që na kanë ardhur kisha dashtë të cekim ligjin për ushqimin dhe të kërkohet nga Qeveria që të harmonizojnë qëndrimet lidhur me këtë ligj

se në kuadër të cilës ministri do të jetë inspektorati i ushqimit ose që të bëjmë edhe një dëgjim publik lidhur me këtë ligj.

**Mimoza Ahmetaj** pyet se si do të jetë mënyra e komunikimit me Organizatën Komunale të Pensionistëve të Lipjanit të cilët i janë drejtuar Kuvendit me një shkresë ? A do të ishte më mirë që së pari të konsultojmë ministrin përkatës e pastaj si Komision të ju përgjigjemi në formë zyrtare .

**Kryetari** tha se lidhur me shkresën e Organizatës Komunale të Pensionistëve të Lipjanit , kërkesa e tyre do të realizohet gjatë shqyrtimit të Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor i cili do të vije në Parlament në muajin shtator.

**Komisioni pas diskutimeve përfundoj që për mbledhjen e radhës të sillen propozimet konkrete me shkrim që plani i punës së Komisionit për vitin 2008 të miratohet.**

*Mbledhja përfundoj në orën 13:40 min.*

*Procesmbajtësja  
Shpresa Haxhijaj*

*Kryetari i Komisionit,*

***Sadik Idriz***